

VENDIM
Nr.574, datë 28.5.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË BASHKISË FIER TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të bashkisë Fier të qarkut të Fierit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 119 (njëqind e nëntëmbëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 841 (tetëqind e dyzet e një).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Fier

Lidhja nr.1

Numrat rendor të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-5,7-12	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
13,15-43,841	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
14,89-92,839	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën social	Në pronësi
52,53,54,55,56	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
59-73	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore sportive	Në pronësi
93	Shërbim funeral	Në pronësi
94,95,100-505,506-565,602	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
566-601	Troje të lira dhe hapësira të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
617-776	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile	Në pronësi

74-88,96-98,793	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
794,798,800	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
795-797,799	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive, kanale të treta).	Në pronësi